


BULETINI TREMUJOR
FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS



TRUSTORJA

PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË PREJ THEMELIMIT



PERIUDHA	1M	3M	1V	3V	5V	NGA THEMELIMI
REZULTATI	-1.14%	-2.07%	+1.10%	+6.23%	+23.11%	+43.45%
BENÇMARKU*	+0.10%	+0.59%	+0.10%	+1.68%	+1.60%	+34.24%

*INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

PERFORMANCA DHE KTHIMI NGA INVESTIMET

ÇMIMI I AKSIONIT:

JANAR	▲ +1.18%
SHKURT	▼ -2.09%
MARS	▼ -1.15%
GJITHSEJ PERFORMANCA NETO	▼ -2.07%

KTHIMI BRUTO:

JANAR	+€19.94 mln
SHKURT	-€34.20 mln
MARS	-€18.31 mln
GJITHSEJ KTHIMI BRUTO	-€32.58 mln

KRYESORET

ÇMIMI I AKSIONIT NË FUND TREMUJORI	€1.4345	MJETET NETO NËN MENAXHIM	€1,632,849,773
MJETE TË SHPAGUARA KËTË TREMUJOR	€9.09 mln	MJETE TË SHPAGUARA KËTË VIT	€9.09 mln
TË PENSIONUAR PËR PERIUdhËN	1,567	TË PENSIONUAR PËR VITIN	1,567
LLOGARI TË KONTRIBUESVE	598,396	LLOGARI AKTIVE NË FUND TË PERIUdhËS	249,830
KONTRIBUES TË RINJ KËTË VIT	6,904	KONTRIBUTE TË ARKËTUARA KËTË VIT	€40.67 mln
SHËRBIME TË OFRUARA KËTË VIT	26,396	LLOGARI NË TRUSTI	88,572

PLASMANET DHE PERFORMANCA PËR SECILIN MENAXHUES / EMETUES NË KËTË TREMUJOR

MENAXHUESI/EMETUESI	EMRI I FONDIT/INSTRUMENTIT /BANKËS	PLASMANET	PJESËMARRJA	PERFORMANCA	KONTRIBUIMI NË PERFORMANCËN BRUTO TË FKPK
Vanguard	Global Stock Index Fund - Euro	€390,211,395	23.90%	-2.65%	-0.62%
Nordea	1-Stable Return Fund	€147,801,729	9.05%	-2.06%	-0.30%
Nordea	1-Global Stable Equity Fund	€138,116,984	8.46%	-9.26%	-0.56%
BNY Mellon	Global Real Return Fund	€34,326,144	2.10%	-2.64%	-0.16%
AXA	Global Inflation Linked Bonds	€100,166,584	6.13%	-0.30%	-0.02%
AXA	WF Optimal Income I EUR	€149,195,175	9.14%	-0.56%	-0.05%
Schroders	ISF Global Diversified Growth	€147,383,621	9.03%	-1.67%	-0.12%
Amundi	Rendement Plus Part I2	€150,400,749	9.21%	+0.16%	+0.01%
Amundi 3M	Amundi 3M - I	€27,920,998	1.71%	-0.06%	-0.00%
BNP Parvest	Diversified Dynamic	€149,001,032	9.13%	-2.14%	-0.18%
Schroders	Strategic Bond - Euro Hedged	€10,415,601	0.64%	+1.34%	+0.01%
Pictet ¹⁾	High dividend selection Z EUR	€28,742,096	1.80%	-5.79%	-0.11%
Thesari i Republikës së Kosovës	Obligacione	€81,632,662	5.00%	+0.50%*	+0.02%
Thesari i Republikës së Kosovës	Fletobligacione	€40,780,860	2.50%	+0.07%*	+0.00%
BKT, BPB, TEB, NLB	Depozita me afat	€50,761,050	3.11%	+0.36%*	+0.01%
BQK - para të gatshme	Të painvestuara	€14,735,190	0.90%	-0.06%	-0.00%
GJITHSEJ		€1,632,849,774	100.00%	-2.07%	-2.07%

¹⁾ | gjithë investimi është tërhequr nga ky fond para përfundimit të TM1 dhe të dhënat janë prezantuar për të ilustruar ndikimin negativ në performancën e FKPK-së.
* Performanca e bazuar në norma fikse të interesit.

-€32.58 MLN KTHIMI BRUTO NGA INVESTIMET

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës kishte këtë tremujor performancë negative nga investimet. Kthimi bruto për TM1 ishte -€32.58 mln, ose një rënie e çmimit të aksionit prej -2.07%. Në TM1 mjetet nën menaxhim u ulën për -€1.80 mln duke rënë në €1,632.85 mln. Në uljen e mjeteve nën menaxhim ndikuan: kthimi nga investimet (-€32.58 mln), shpagimi i pensioneve (-€7.19 mln) tarifat menaxhuese (-€1.87 mln) dhe refondimet (-€26.2 mijë), ndërkohë që në rritje ndikuan kontributet e reja që ishin €40.67 mln për periudhën.

FAKTORËT ME NDIKIM

Ky tremujor filloi pozitivisht dhe në ngritje për tregun financiar në SHBA, ku përmirësimi i treguesve makroekonomikë e çoi besimin e bizneseve (paprishëm) në nivelet më të larta prej dekadash. Megjithatë tremujori përfundoi në kuota negative, me një rritje të theksuar të luhatshmërisë, i ndikuar kryesisht nga rritja e normave të interesit (prej 25 pikëve bazë) dhe fuziqimit të sanksioneve tregtare të SHBA-ve ndaj eksporteve të Kinës. Jehona e këtyre lëvizjeve në SHBA u reflektua edhe në zonat e tjera kryesore financiare, BE e Japoni, që po ashtu e mbyllën tremujorin në performancë negative. Vetëm tregjet financiare në vendet në zhvillim tejkalun pritshmëritë, duke e përmbyllur periudhën në kuota pozitive, në terma të dollarit amerikan. Si rrjedhim i gjithë lëvizjeve makroekonomike këtë periudhë kishim edhe një rritje të ndjeshme të inflacionit global.

Gjithsesi se këtyre lëvizjeve të tregut financiar i nënshtrohen edhe investimet e FKPK-së që, megjithatë, nuk u reflektuan në kuota alarmante në çmimin e njësive të FKPK-së.

PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE

Nga 11 fonde investuese aktive në fund të TM1, dy fonde investuese e mbyllën periudhën me kthim pozitiv nga investimet dhe 9 të tjera ishin me performancë negative. Veç këtyre, edhe fondi i shitur në tërësi nga Pictet HDS rezultoi me performancë negative (prej -5.79%). Dy fondet me performancë pozitive, fondi i pastër në bono i Schroders SB (me +1.34%), dhe fondi në multi-asete i Amundi RP (me 0.16%) përfituan nga prezenca e fletobligacioneve në investimet e tyre.

Në anën tjetër, performancë negative kishin kryesisht fondet me ekspozim më të lartë në aksione, dhe varësisht nga ekspozimit sektorial. Kështu fondi me performancën më negative për periudhën ishte i Nordea GSEF (-9.26%) që u ndikua nga prezenca dominuese në portofolin e tij investues të dy sektorëve (kujdesi shëndetësor dhe TI). Këta ishin edhe dy sektorët më të prekur nga lëvizjet në tregjet financiare këtë tremujor, duke nënperformuar përtej pritshmërive. Ndërsa fondet e tjera kishin performancë negative më të moderuar, që silllej prej -0.56% (fondi global i aksioneve në bono i AXA GILB) dhe -2.65% (fondi i pastër në aksione i Vanguard GSIF).

Nga ana tjetër, investimet në Kosovë (në obligacione dhe fletobligacione të Qeverisë dhe në depozita bankare) ishin me norma të paracaktuara të interesit dhe kontribuan pozitivisht me rreth 2% në performancën e përgjithshme të FKPK-së për këtë periudhë.

PERFORMANCA NETO E INVESTIMEVE TM1 2018

-2.07%

KRYESORET E TREMUJORIT

BORDI MBAJTI MBLEDHJEN E PARË PËR 2018

Bordi Drejtues i FKPK-së në mbledhjen e marsit 2018 ka shqyrtuar gjendjen e të gjitha investimeve dhe fondeve investuese, dhe të gjitha rekomandimet e komisioneve përkatëse. Bordi Drejtues në këtë mbledhje mori vendimet në vijim: 1) Të shiten €90 mln euro nga fondi i Nordea SRF, 2) të shiten €72 mln nga fondi i BNY Mellon, 3) të shitet i gjithë investimi në Pictet HDS (prej €32 mln), meqë Bordi beson se në kategorinë ku ky portofol operon ka pak pritshmëri për rritje të vlerës; 4) të investohen €36 mln shtesë në fondin e Schroders GDG, 5) të investohen €22 mln shtesë në fondin e BNP Paribas PDD, 6) të investohen €40 mln shtesë në fondin e AXA WFOI, 7) të investohen €64 mln shtesë në fondin e Amundi RP, dhe 8) të investohen €32 mln shtesë në fondin e Vanguard GSIF.

UDHËHEQËS TË FKPK- SË PRESIN NË TAKIM DREJTUESIT E USAID-IT

Më 5 mars 2018 drejtues të Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar i bënë vizitë FKPK-së. Vizitës së USAID i printe z. James Hope, Drejtor i Misionit të USAID në Kosovë, i shoqëruar nga z. Brian Martalus, Drejtor i Zyrës për Zhvillim Ekonomik, dhe znj. Dardane Peja, specialiste për menaxhimin e projekteve. Nga ana e FKPK-së në takim i pritën z. Ymer Havolli, Kryesues i Bordit Drejtues të FKPK-së, i shoqëruar nga z. Hajdar Korbi, anëtar i Bordit Drejtues, nga z. Valdrin Kasumaj, anëtar i Bordit Drejtues si dhe nga z. Adrian Zalli, Drejtor Menaxhues i FKPK-së. Havolli, pasi i uroi mirëseardhjen përfaqësuesve të USAID-it, iu shprehu falënderimin dhe mirënjohjen që FKPK-ja ka për ndihmën e çmuar e të jashtëzakonshme që USAID-i ka dhënë për themelimin dhe zhvillimin e këtij institucioni. Ai po ashtu i njoftoi shkurtimisht mysafirët me zhvillimin e institucionit prej themelimit e deri në fund të 2017. Nga ana e tij z. Hope, duke falënderuar për mikpritjen, e çmoi lart historikun dhe rëndësinë e këtij institucioni për Kosovën, duke e vlerësuar si një shembull pozitiv dhe të suksesshëm të ngritjes dhe pjekjes së vazhdueshme të këtij institucioni prej themelimit (para 16 vjetësh), dhe se FKPK-ja është ndër projektet më të suksesshme të USAID në Kosovë.

€9.09 MLN PENSIONE TË TËRHEQURA NË TM1 2018

Vlera e pensioneve të shpaguara këtë tremujor arriti në total €9.09 mln, ndërkohë që numri i llogarive të reja nga të cilat u tërhoqën mjetet numëruan 1,567. Krahasuar me TM1 2017 vlera e shpague për pensione u rrit për 37% (TM1 2017: €6.66 mln), ndërsa në numër ishin 19% më shumë përfitues këtë tremujor (TM1 2017: 1,321). Po ashtu edhe krahasuar me tremujorin paraprak (TM4 2017) kishim rritje edhe më të fortë të shpagimeve si në vlerë (+51%) ashtu edhe në numër (+47%).

SHKON NË RRETH 86 MIJË NUMRI I LLOGARIVE NË eTRUSTI

Numri i kontribuuesve që kanë hapur llogari në eTrusti deri në fund të TM1 2018 arriti në 88,572 ose një rritje prej 11% për këtë tremujor (nga 79,867). Është objektiv i institucionit që deri në fund të këtij viti numri i përdoruesve të shkojë në rreth 100 mijë. Shërbimi eTrusti ofrohet falas dhe çdo kontribuues mund të hapë llogari duke vizituar adresën në vijim: <https://online.trusti.org/>

BOTUES:

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
Maj 2018

REDAKTOR:

Vërshim Hatipi

AUTOR:

Jeton Demi

KONTAKT:

Rr. "Agim Ramadani" Nr. #182-184
10000 Prishtinë

Shërbimet për klientë: +381-38-600-025
Zyra Qendrore: +381-38-600-020

info@trusti.org
www.trusti.org